



REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilajeno Mardana 20.02.2010			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013/1806-			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 51.2 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 37 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/5165 të datës 18.11.2008 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2010, aprovon këtë:

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI DHE ÇËSHTJE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, FORMON Komisionin për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.

Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve:

1. Shqipe Azemi – anëtar,
2. Vjollca Halili – anëtar,
3. Baki Sylejmani - anëtar,
4. Shqipe Emerllahu - anëtar,
5. Emrush Azemi – anëtar,

Komisioni për Shëndetësi dhe Çështje Sociale në mbledhjen e parë do ta emëroj Kryetarin e Komisionit.

Neni 2

Komisioni nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të shqyrtoj çështjet të cilat kanë të bëjnë me gjendjen në Shëndetësi dhe gjendjen Sociale të banorëve të Komunës së Vitisë dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime për tejkalimin e gjendjes në shëndetësi dhe në mbrojtjen sociale.

Kryetari i Kuvendit, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Kryetari i komisionit më detalisht mund ti përcaktojnë detyrat e këtij komisioni.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Komisionit.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. anëtarëve të komisionit
2. Arkivit



KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYETARI
Skenderbe Hebibi